# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-402050**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Ylli Zalla lihet në burg/ Avokati: Nuk paraqet rrezikshmëri të lartë, armët ishin të vjetra dhe municionet pjesërisht të papërdorshme |
| ADRESA | `https://www.balkanweb.com/ylli-zalla-lihet-ne-burg-avokati-nuk-paraqet-rrezikshmeri-te-larte-armet-ishin-te-vjetra-dhe-municionet-pjeserisht-te-paperdorshme/` |
| BURIMI | balkanweb.com |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 6 shtator 2026, 13:21:25 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 19 gusht 2026, 09:26:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 19 gusht 2026, 09:25:00 UTC → 19 gusht 2026, 09:27:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `ec960b404a30a78c48b027bd1126a8d953a713064358d6bd898ec42fb3eaca4a` |
| TEKSTI | `5bc5bdb38a3b5e8420f08a30f6600316250cd78d01f0dc61211af9ee1a88f9e7` |
| PAMJA | `f3019bd25087da61da2bf842e6ea12dc8a5276b95e468d84968be9188279e791` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `9e99c01e0304e9e5384a34a6d15924111e13fcdfddb62f511b536685b4ced492` |
| E MËPARSHMJA | `ffb8e488a8e0ef521614a0e0bb0734e1090eef8a6daaa526da602511e95f070c` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/9e99c01e0304e9e5384a34a6d15924111e13fcdfddb62f511b536685b4ced492`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# Ylli Zalla lihet në burg/ Avokati: Nuk paraqet rrezikshmëri të lartë, armët ishin të vjetra dhe municionet pjesërisht të papërdorshme

19 Gusht, 2026 11:26

**Madhësia e tekstit:**

Balkanweb app Download on Apple Store Get it on Google Play

Gjykata e Tiranës ka caktuar masën e sigurisë "arrest në burg" për Ylli Zallën, ndërsa mbrojtja e tij ka kërkuar një masë më të lehtë, duke kundërshtuar pretendimin se ai paraqet rrezikshmëri të lartë shoqërore.

Avokati i Zallës argumentoi se as personi dhe as vepra për të cilën ai dyshohet nuk paraqesin rrezikshmëri të veçantë. Sipas mbrojtjes, armët dhe municionet e sekuestruara janë gjetur në pjesën e pasme të banesës, mes ferrave, pa masa të veçanta për ruajtjen apo ambalazhimin e tyre.

Mbrojtja pretendon gjithashtu se disa prej kapsollave detonatore nuk kanë qenë funksionale, ndërsa disa mjete shpërthyese nuk kanë qenë të lidhura në mënyrën e duhur për të shkaktuar shpërthim.

Sa i takon armëve, avokati deklaroi se bëhet fjalë për armë të vjetra, të prodhimit kinez, të viteve '80. Edhe sasia e kanabisit e sekuestruar, sipas tij, ka qenë e ekspozuar ndaj faktorëve atmosferikë dhe nuk tregon kujdes të veçantë për ruajtjen e saj.

Avokati theksoi se Ylli Zalla nuk është i përfshirë në ngjarje të tjera kriminale dhe se nuk ka prova që materialet e gjetura të jenë përdorur në ngjarje të tjera apo që ai të ketë ndërmarrë veprime për shitjen e lëndëve narkotike.

Një tjetër argument i mbrojtjes lidhet me mënyrën e dorëzimit të tij. Avokati tha se, pavarësisht angazhimit të forcave të shumta të policisë dhe përdorimit të dronëve gjatë operacionit, Zalla nuk u kap nga forcat e policisë, por vendosi vetë të dorëzohej.

Sipas avokatit, ai ka thirrur një efektiv që ndodhej pranë banesës, i është prezantuar dhe është dorëzuar, me qëllim që të sqaronte pozicionin e tij.

Për këto arsye, mbrojtja kërkoi që ndaj Ylli Zallës të vendosej një masë më e lehtë sigurie, por gjykata vendosi "arrest në burg".

**Deklarata e avokatit Dritan Gila:**

Ylli Zalla nuk paraqet asnjë rrezikshmëri të lartë si person dhe as veprat për të cilat akuzohet nuk paraqesin rrezikshmëri të veçantë.

Së pari, armët dhe municionet e sekuestruara janë gjetur në pjesën e pasme të banesës, në ferra, pa asnjë rregull apo masë për ruajtjen e tyre dhe pa qenë të paprekura apo të ambalazhuara.

Së dyti, disa nga kapsollat detonatore nuk kanë qenë të afta të shkaktonin shpërthim, ndërsa disa bomba nuk kanë qenë të lidhura në mënyrën e duhur.

Së treti, armët janë prodhime të vjetruara, rreth 50-vjeçare, të prodhimit kinez, të vitit 1982. Edhe sasia e kanabisit të sekuestruar ka qenë nën efektin e agjentëve atmosferikë, çka tregon mungesë të çdo lloj kujdesi nga ana e të arrestuarit.

Në lidhje me rrezikshmërinë e personit, Ylli Zalla nuk paraqet asnjë rrezikshmëri, pasi nuk është i përfshirë në asnjë ngjarje kriminale dhe nuk ka të dhëna se materialet e sekuestruara në ferra, pas pjesës së oborrit, janë përdorur në ngjarje të tjera apo se ai vetë ka ndërmarrë veprime për shitjen e lëndëve narkotike.

Në këtë drejtim, me interes të veçantë është fakti se Ylli Zalla është dorëzuar vetë. Është e vërtetë që policia është angazhuar me dron dhe me efektivë të shumtë, por, pavarësisht operacioneve të zhvilluara për kapjen e tij, nuk ka mundur ta arrestojë. I vetmi element që solli suksesin e operacionit ishte dëshira e Yllit Zalla për t'u dorëzuar dhe për të sqaruar pozicionin e tij.

Videot publike para shtëpisë së tij e tregojnë këtë. Madje, ai vetë ka thirrur me zë një person që i është dukur pjesë e forcave RENEA dhe i është prezantuar, duke u dorëzuar.

Për këto arsye, mbrojtja ka kërkuar caktimin e një mase më të lehtë sigurie, në vend të masës së arrestit në burg të kërkuar nga prokuroria.

**© BalkanWeb**

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

### Të ngjashme

Protesta2

**Mbyllet tubimi i 102, thirrjet e protestuesve: Nesër më shumë**

09 Shtator, 2026

Img 0527

**VIDEO/ PSG e nis frikshëm Championsin, Liverpool fiton ndaj Atleticos, një gol vendos Napoli-Arsenal**

09 Shtator, 2026

loading...

### Të Fundit nga -Kronikë

[Divjake]

[41 ditë protestë! Qytetarët nuk dorëzohen: Divjaka bashki! Marshim në rrugët e qytetit]

09 Shtator, 2026

[Çelësat brenda në makinë/ Një person vjedh automjetin në Pogradec, por më pas…]

09 Shtator, 2026

[Bie zjarr në Bago të Kavajës, rrezikohen 3 banesa nga djegia]

09 Shtator, 2026

[Zjarr në Aliko të Bashkisë Finiq, digjet sipërfaqe me pemë dhe shkurre]

09 Shtator, 2026

[Emri/ E lidhën dhe e ekzekutuan në makinë. Automjetin më pas e hodhën në lumë, vritet brutalisht shqiptari në Itali (Detaje)]

09 Shtator, 2026

[Prova të reja për Belinda Ballukun/ SPAK njoftim zyrtar: I sekuestrohet vila në Palasë, nën hetim për korrupsion, pastrim parash dhe shkelje të barazisë në tendera]

09 Shtator, 2026

### Kategoria Video

[Mbyllet tubimi i 102, thirrjet e protestuesve: Nesër më shumë]

09 Shtator, 2026

[VIDEO/ PSG e nis frikshëm Championsin, Liverpool fiton ndaj Atleticos, një gol vendos Napoli-Arsenal]

09 Shtator, 2026

[102 ditë protestë/ Nuk ndalen protestuesit, vazhdojnë marshimin]

09 Shtator, 2026

[“Dorëheqje”/ Protestuesit ulen tek Kryqëzimi tek 21 Dhjetori, bllokojnë qarkullimin e mjeteve]

09 Shtator, 2026

[“Ju erdhi fundi”/ Protestuesit mbërrijnë tek Vasil Shanto, thirrje të forta kundër qeverisë: Rama në burg, Balluku në burg]

09 Shtator, 2026

[LIVE- Vijon aksioni qytetar! Protestuesit marshojnë drejt Policisë së Tiranës, kumbojnë thirrjet: Ju erdhi fundi!]

09 Shtator, 2026

loading...
Balkanweb app Download on Apple Store Get it on Google Play
Kerko ketu

### Lajmet e fundit

- **[Mbyllet tubimi i 102, thirrjet e protestuesve: Nesër më shumë]**

  09 Shtator, 2026

  **[VIDEO/ PSG e nis frikshëm Championsin, Liverpool fiton ndaj Atleticos, një gol vendos Napoli-Arsenal]**

  09 Shtator, 2026

  **[102 ditë protestë/ Nuk ndalen protestuesit, vazhdojnë marshimin]**

  09 Shtator, 2026

  **[“Dorëheqje”/ Protestuesit ulen tek Kryqëzimi tek 21 Dhjetori, bllokojnë qarkullimin e mjeteve]**

  09 Shtator, 2026

  **[“Ju erdhi fundi”/ Protestuesit mbërrijnë tek Vasil Shanto, thirrje të forta kundër qeverisë: Rama në burg, Balluku në burg]**

  09 Shtator, 2026

  **[LIVE- Vijon aksioni qytetar! Protestuesit marshojnë drejt Policisë së Tiranës, kumbojnë thirrjet: Ju erdhi fundi!]**

  09 Shtator, 2026

- News24 Fundjavë
- Oponencë
- Podcast
- Sport News
- Studio 24
- Tak Fak
- Vetting

**Kategori**

- Fillimi
- Minutë pas minute
- Shqipëria
- Politikë
- Kronikë
- Ekonomi
- Kosova
- Rajoni
- Sport
- Bota
- Kulturë
- Metropol

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.